



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1600/<sub>4</sub> Prot

Tiranë, më 23 .11 .2021

VENDIM

Nr. 51 , datë 23 . 11 .2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Znj. (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1600 Prot., datë 30.09.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Krujë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet e-mail-it datë 14.09.2021, depozituar në adresën [drini.masha@kruja.gov.al](mailto:drini.masha@kruja.gov.al); [info@kruja.gov.al](mailto:info@kruja.gov.al) ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, si vijon:

1. Kopjet e Vendimeve të Këshillave Bashkiakë me listën e përfituesve sipas klasifikimit bashkëngjitur dhe VKB të cilat mund t’i kenë ndryshuar klasifikimet për sa i përket:

- Bonuset e qerave;
- Grantet e rikonstruksionit (DS1, DS2, DS3);
- Përfituesit e njësisve të reja të banimit (për shkak të dëmeve DS4, DS5) bashkë me strukturën e banesës së përfutuar dhe numrin e anëtarëve për familje;
- Përfitues që kanë marrë grant për rindërtimin e banesave (DS4, DS5), numrin e anëtarëve për familje dhe vlerën e përfutuar

2. Listat në format Excel për secilën VKB dhe për çdo përfitues (DS1, DS2, DS3), në nivel përfituesi që duhet të ketë:

- *Nr. i aplikimit;*
- *Data e aplikimit;*
- *Emër Mbiemër;*
- *Klasifikimi i demit;*
- *Data e VKB;*
- *Ndryshimi i klasifikimit të demit (nëse është bërë);*
- *Data e VKB që ndryshon klasifikimin;*
- *Data e pagesës;*
- *Vlera e pagesës;*
- *Njësia administrative ku ka ndodhur dëmi.*

3. Listat në format Excel për secilën VKB dhe për çdo përfitues (DS4, DS5), në nivel përfituesi (që përfitojnë njësi të reja) duhet të ketë:

- *Nr. i aplikimit;*
- *Data e aplikimit;*
- *Emër Mbiemër;*
- *Klasifikimi i demit;*
- *Data e VKB;*
- *Ndryshimi i klasifikimit të demit (nëse është bërë);*
- *Data e VKB që ndryshon klasifikimin;*
- *Nr. e anëtarëve të familjes;*
- *Strukturën e banesës së përfituar;*
- *Datën e dorëzimit të banesës (nëse është dorëzuar);*
- *Njësia administrative ku ka ndodhur dëmi;*
- *Llojin e njësisë (kolektive apo individuale).*

4. Listat në format Excel për secilën VKB dhe për çdo përfitues (DS4, DS5), në nivel përfituesi (që përfitojnë grant për ta rindërtuar vetë banesën) duhet të ketë:

- *Nr. i aplikimit;*
- *Data e aplikimit;*
- *Emër Mbiemër;*
- *Klasifikimi i demit;*
- *Data e VKB;*
- *Ndryshimi i klasifikimit të demit (nëse është bërë);*
- *Data e VKB që ndryshon klasifikimin;*
- *Nr. e anëtarëve të familjes;*
- *Strukturën e banesës së përfituar;*
- *Data e pagesës;*
- *Vlera e pagesës;*
- *Njësia administrative ku ka ndodhur dëmi.*

5. Listat në format Excel për secilën VKB dhe për çdo përfitues (bonus qiraje), në nivel përfituesi dhe në nivel mujor, që duhet të ketë:

- *Nr. i aplikimit;*
- *Data e aplikimit;*

- *Emër Mbiemër;*
- *Klasifikimi i demit;*
- *Data e VKB;*
- *Ndryshimi i klasifikimit të demit (nëse është bërë);*
- *Data e VKB që ndryshon klasifikimin;*
- *Data e pagesës së kryer sipas secilit muaj;*
- *Vlera e pagesës së kryer sipas secilit muaj;*
- *Nr. e anëtarëve të familjes;*
- *Strukturën e banesës së marrë me qirasë;*
- *Njësia administrative ku ka ndodhur dëmi.*

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 1600/1 prot., datë 05.10.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, brenda datës 12.10.2021.

Në tejkallim të afatit, në mungesë të një përgjigjeje nga Autoriteti Publik, ankuesja me e-mail-in datë 25.10.2021, ka kërkuar nga Zyra e Komisionerit detyrimin e Autoritetit Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, Zyra e Komisionerit me e-mail-in datë 28.10.2021, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin përfundimtar mbi pretendimin e ngritur nga ankuesja.

Autoriteti Publik nëpërmjet koordinаторit për të drejtën e informimit me e-mail-in datë 28.10.2021 ka kërkuar kohë për të bërë të mundur kthimin e përgjigjes me arsyetimin se: “*Së pari, procesi i rindërtimit është tejet voluminoz e për të cilën kërkon kohën e saj, për të përpiluar një përgjigje e cila përfshin 2 vite punë intensive nga vlerësimi i dëmeve e deri në përfitimin e granteve apo marrjen e shtëpive. Sikundër ngrita edhe në mbledhje, të 10 bashkitë duhet të kenë një platformë ku të hedhin të gjitha të dhënat e rindërtimit, qoftë për të rritur transparencën ndaj publikut, donatorëve dhe për të lehtësuar të gjithë kohën, që një qytetar apo media kërkon për programin e rindërtimit. Duke kërkuar mirëkuptimin Tuaj edhe ndaj situatës shumë të vështirë me ujën e pijshëm në Krujë, ku*

*unë jam i ngarkuar në manaxhimin e kësaj situate, të kem më tepër kohë për të kthyer përgjigje sipas kërkesave të ankueses”.*

Ankuesja, në tejkallim të afatit dy javor të lejuar për kthimin e përgjigjes nga kjo e fundit sipas e-mail-it datë 28.10.2021, me shkresën nr. 1600/3 Prot., datë 17.11.2021 ka vijuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar është informacion publik në kuptim të LDI pasi lidhet me fondet e përfituara nga buxheti i shtetit në procesin e rindërtimit për të dëmtuarit nga tërmeti.

Po ashtu, referuar e-mail-it të datës 28.10.2021, Autoriteti Publik konfirmon disponimin e informacionit të kërkuar, por kërkonte kohë për kthimin e përgjigjes për shkak të volumit të informacionit, provohet se informacioni i kërkuar disponohet nga Autoriteti Publik.

Gjithashtu, konstatohet se Autoriteti Publik, nuk ka provuar se është përpara ndonjë prej kufizimeve të përcaktuara në nenin 17 të LDI, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, për mosvënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “*Informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, se *për shkak të volumit të informacionit të kërkuar dhe të situatës së vështirë të krijuar me ujën e pijshëm kërkohet kohë*, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron. Autoriteti Publik, pavarësisht volumit të madh të informacionit të kërkuar, si dhe situatës së vështirë në të cilën ndodhet Bashkia në këtë periudhë, në asnjë rast nuk përjashtohet nga detyrimi për kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor, për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën.

Bazuar në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet qartë se, *objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike*. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “*prodhuesit*” apo “*mbajtësit*” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Gjithashtu, në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 10, të LDI, parashikohet se: *“Koordinatori për të drejtën e informimit... a) i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentacionin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;”*.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësisive të qeverisjes vendore i`u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar *“Transparenca e veprimtarisë së njësisive të vetëqeverisjes vendore”*, parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”*.

Bazuar në pikën 3, fusha 1, të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.9.2018 të Komisionerit, *“Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, në pikën 3, Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak përfshin bërjen publike të - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ”*. Për rrjedhojë, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Po ashtu, kërkesa për informacion e paraqitur lidhet me përfitime nga buxheti i shtetit i cili do t’i shërbente transparencës së veprimtarisë së Autoritetit Publik në procesin e rindërtimit. Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson se, Autoriteti Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*, si dhe sipas parashikimeve të nenit 5 dhe 6 të të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të LDI parashikohet se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, *“autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”*. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative*. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e znj. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Krujë, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1600 Prot., datë 30.09.2021 të znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Krujë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 14.09.2021, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, brenda datës 02 . 11 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 23 . 11 .2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

